


Ekskluzive

Ekskluzive | Ky është 27-vjeçari që u gjet me plumb në gjoks në Pejë – arma u gjet në kombi, çfarë dyshon Policia



Sinjali.com

25 Gusht 2026 08:36




Një rast i pazakontë me armë zjarri ka ndodhur në Vitomiricë të Pejës, ku një 27-vjeçar është gjetur i plagosur në gjoks, ndërsa Policia ka nisur hetimet për të zbardhur rrethanat se si erdhi deri te plagosja, raporton ekskluzivisht Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se personi i përfshirë në këtë rast është **Ardit Krasniqi** rreth 27-vjeçar.

Ngjarja ka ndodhur më 24 gusht, rreth orës 14:10, në rrugën “Hysni Hyka” në fshatin Vitomiricë.

Pas pranimit të informatës për rastin, njësia patrulluese ka dalë menjëherë në lokacion, ku policët kanë hasur Krasniqin me një plagë të shkaktuar nga arma e zjarrit në pjesën e majtë të gjoksit.

**Lexo edhe**

Mister në Vitomiricë të Pejës | 27-vjeçari gjendet i plagosur me armë në gjoks – Policia gjen armën dhe 11 fishekë në



Në vendngjarje ka intervenuar edhe ekipi mjekësor, i cili i ka ofruar ndihmën e parë 27-vjeçarit dhe më pas e ka transportuar atë në Spitalin Rajonal të Pejës për trajtim të mëtejshëm.

Por ajo që kanë gjetur policët në vendngjarje ka ngritur dyshime për mënyrën se si mund të ketë ndodhur plagosja.

Në afërsi është hasur një kombi Volkswagen, ndërsa brenda tij Policia ka gjetur një armë zjarri dhe 11 fishekë të kalibrit 7.62×39 mm.

Një gëzhgjë e të njëjtit kalibër është gjetur në tokë, në afërsi të automjetit.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, dyshimet fillestare të Policisë janë se arma e gjetur në kombi është përdorur nga vetë Krasniqi dhe se 27-vjeçari dyshohet se e ka shkaktuar vetë plagosjen.

Megjithatë, bëhet fjalë për dyshimet fillestare dhe dinamika e saktë e incidentit mbetet objekt i hetimeve.

Rasti është iniciuar për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armës” dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”.

Hetuesit tashmë pritet të zbardhin rrethanat e plota të incidentit dhe të përcaktojnë saktësisht se si erdhi deri te plagosja e 27-vjeçarit dhe çfarë ndodhi para se Policia ta gjente të plagosur në Vitomiricë.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

ARMA

ekskluzive

pumb


Të tjera:



Gjykata cakton shqyrtimin fillestar ndaj 53 të akuzuarve për krime lufte

Kosovë

10 raste të reja me fruth, Kosova shkon në 147 raste të konfirmuara

Kosovë

AI mund të parashikojë rrezikun e kancerit të gjirit deri në 5 vjet më herët

Shëndeti

Pas martesës, Dua Lipa: Më interesojnë kompleksitetet e një marrëdhënieje



Arma e babait, kthimi nga Gjermania dhe vdekja e 25-vjeçares shtatzënë– krejt çka...

Siguri

PDK paralajmëron protesta masive: Thirrreni seancën konstituive dhe...

Politikë

Tragjedi në Guine: Shembet deponia e mbeturinave, 30 persona humbin jetën



Zelensky kundërshton zgjedhjet gjatë luftës: Do ta shkatërronin Ukrainën

Botë

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera